

Udhëzime praktike

Kërkesat për masa të përkohshme¹

(Neni 39 i Rregullave të Gjykatës)

Sipas Neni 39 të Rregullave të Gjykatës, Gjykata mund të caktojë masa të përkohshme, të cilat do të jenë të detyrueshme për shtetin në fjalë.

Masat e përkohshme urdhërohen vetëm në raste përjashtimore. Gjykata urdhëron një shtet anëtar të zbatojë një masë të tillë vetëm kur, pasi ka shqyrtuar të gjithë informacionin përkatës, ajo konsideron se kërkesi mund të përballë me një rrezik të menjëhershëm për një dëm të pariparueshëm.

Ankuesit ose përfaqësuesit e tyre² që bëjnë një kërkesë për një masë të përkohshme bazuar në Nenin 39 të Rregullave të Gjykatës duhet të respektojnë kërkesat e përcaktuara më poshtë.

I. Informacioni shoqërues

Çdo kërkesë e paraqitur në gjykatë duhet të shpjegojë arsyet. Ankuesi duhet të specifikojë në mënyrë të detajuar arsyet mbi të cilat bazohen frika e tij/saj, natyrën e rreziqeve të pretenduara dhe dispozitat e Konventës që pretendohet se janë shkelur.

Një referencë e thjeshtë ndaj parashtresave në dokumente të tjera ose procedura vendore nuk është e mjaftueshme. Është thelbësore që kërkesat të shoqërohen me të gjitha dokumentet e nevojshme mbështetëse, veçanërisht vendimet përkatëse të autoriteteve, gjykatave etj., së bashku me çdo material tjetër që konsiderohet se vërteton pretendimet e ankuesit.

Kërkesat të cilat nuk përfshijnë informacionin e nevojshëm për të marrë një vendim normalisht nuk do t'i paraqiten një gjyqtari për vendim. Gjykata nuk do të kontaktojë domosdoshmërisht ankuesit nëse kërkesa e tyre për masa të përkohshme nuk është e plotë.

Kur dosja ka qenë paraprakisht në pritje për shqyrtim nga Gjykata, ankuesi duhet t'i referohet numrit të çështjes që i është caktuar më parë.

Për rastet që lidhen me dëbimin ose ekstradimin, duhet të jepen detaje për datën dhe orën e pritjes të largimit, adresën ose vendin e mbajtjes së ankuesit dhe numrin zyrtar të referencës së çështjes. Gjykata duhet të njoftohet për çdo ndryshim të këtyre të dhënave (data dhe ora e largimit, adresa etj.) sa më shpejt që të jetë e mundur.

Kërkesa duhet, kur është e mundur, të jetë në një nga gjuhët zyrtare të Palëve Kontraktuese.

Gjykata mund të vendosë të marrë vendim për pranueshmërinë e çështjes në të njëjtën kohë me shqyrtimin e kërkesës për masa të përkohshme.

1. Udhëzues praktik i nxjerrë nga Kryetari i Gjykatës në përputhje me Nenin 32 të Rregullave të Gjykatës më 5 mars 2003 dhe i ndryshuar më 16 tetor 2009, 7 korrik 2011 dhe 3 maj 2022.

2. Është thelbësore që të jepen të dhënat e plota të kontaktit.

II. Kërkesat duhen parashtruar nëpërmjet "Faqes së të GJEDNJ për Nenin 39 ", me faks ose me postë

Kërkesat për masa të përkohshme sipas Nenit 39 duhet të dërgohen ose nëpërmjet faqes së GJEDNJ-së për Nenin 39, ose me faks, ose me postë³.

Gjykata nuk do të trajtojë kërkesat e dërguara me email. Të gjitha kërkesat e dërguara me faks ose postë duhet të përmbajnë shënimin vijues me shkronja të theksuara në krye të kërkesës :

"Rule 39 – Urgent

Personi për t'u kontaktuar (emrin dhe detajet e kontaktit): ...

[Në rastet e dëbimit ose ekstradimit]

Data dhe ora e planifikuar e largimit dhe destinacioni: ..."

III. Dorëzimi në kohë i kërkesave

Kërkesat për masa të përkohshme normalisht duhet të dërgohen sa më shpejt që të jetë e mundur pas marrjes së vendimit përfundimtar të brendshëm, në mënyrë që t'i mundësohet Gjykatës dhe Sekretarisë së saj që të kenë kohë të mjaftueshme për të shqyrtuar çështjen. Gjykata mund të mos jetë në gjendje të trajtojë kërkesat që mbërrijnë më pak se një ditë pune përpara dëbimit ose ekstradimit⁴.

Kur vendimi përfundimtar i brendshëm pritet nga çasti në çast dhe ekziston rreziku i zbatimit të tij menjëherë, veçanërisht në rastet e dëbimit ose ekstradimit, ankuesit dhe përfaqësuesit e tyre duhet të paraqesin kërkesën për masa të përkohshme pa e pritur atë vendim, duke treguar qartë datën në të cilën do të merret vendimi dhe që kërkesa qëndron me kusht që vendimi përfundimtar i brendshëm të jetë negativ.

IV. Masat e brendshme me efekt pezullues

Gjykata nuk shqyrton ankesat kundër vendimeve të gjykatave vendase dhe kërkuesit në çështjet e dëbimit ose ekstradimit duhet të përdorin mjetet juridike të brendshme që mund të pezullojnë largimin, përpara se të aplikojnë në Gjykatë për masa të përkohshme. Kur është e mundur për një ankues që të përdorë mjetet juridike të brendshme që kanë efekt pezullues, Gjykata nuk do të zbatojë Nenin 39 për të parandaluar largimin.

V. Përcjellja e kërkesave

Ankuesit që aplikojnë për një masë të përkohshme sipas Nenit 39 duhet t'i përgjigjen korrespondencës nga Sekretariati i Gjykatës. Në veçanti, kur kërkesa për masë të përkohshme është refuzuar, ata duhet të informojnë Gjykatën nëse dëshirojnë të vijojnë me ankesën e tyre. Kur është zbatuar një masë e përkohshme, ata duhet të informojnë rregullisht dhe menjëherë Gjykatën për situatën e çdo procesi të brendshëm në pritje. Mos respektimi i këtij rregulli, mund të çojë në çregjistrimin e çështjes nga lista e çështjeve të Gjykatës.

3. Duhet të mbahet parasysh që kërkesat e dorëzuara me postë nuk duhen dërguar me shërbimin e thjeshtë.

4. Lista e festave publike dhe festave të tjera kur mbyllet Sekretaria (Sekretariati) e Gjykatës mund të konsultohet në faqen e internetit të Gjykatës: www.echr.coe.int/contact.